



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2024



Komuna e Kaçanikut

### **Procesverbal**

**Takimi i V-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024**

**Më 29.X.2024**

Në takim prezantuan:

**Besim Ilazi, Kryetar i Komunës**

**Zahir Doda, DKA**

**Jaser Jaha, Stacioni i Policisë-Kaçanik**

**Fidaim Fazliu-KBI**

**Fatmir Qaka, EVSB**

**Bujar Bajra-Spektori i Emergjencave Civile Komunale**

**Elmihane Malsiu-HANDIKOS**

**Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal**

**Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve**

**Ylber Tusha-Përfajqsues i bizneseve**

**Shemsedin Abazi-KLSP**

**Gzim Morina-FSK**

**Menduh Krasniqi-Inspektorati Komunal**

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës .

- 1.Miratimi i process verbalit nga mbledhja e kaluar .
- 2.Gjendja e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve në Komunën e Kaçanikut .
- 3.Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje .
- 4.Aktivitete vetëdijuese për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike .
- 5.Formimi i grupit punues për hartimin e planit të punës të KKSB-së për vitin 2025.
- 6.Të ndryshme

### **1.Miratimi i proces verbalit nga mbledhja e kaluar .**

Pika e parë e rendit të ditës u miratua nga të pranishmit .

### **2.Gjendja e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve në Komunën e Kaçanikut**

Për gjendjen e sigurisë Kryetari fjalën ja dha zv.Komandantit të stacionit të Policisë z.Jaser Jaha.

**Jaser Jaha** – Gjendja e sigurisë në Komunën tonë në periudhën në mes dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile me përjashtim të disa rasteve që do i përmend -Ghithsej janë 64 raste ku prej tyre 46 janë vepra penale ,18 aksidente trafiku .

Nga këto raste i kemi 10 lëndime trupore ,mbajtje në pronësi të paautorizuar të armëve 4 raste, vjedhje 5 raste ,vjedhje e rëndë 3 raste ,dhunë në familje 1 rast , dëmtim i pasurisë 1 rast ,heqje e instalimeve publike 4 raste ,falsifikim i dokumenteve 2 raste ,shpërndarje të narkotikëve 3 raste , kanosje 4 raste ,sulm 3 raste ku njëri është ndaj personit zyrtarë , aksidente trafiku 18 raste. Gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur edhe ligjërata nëpër shkolla me temë – Siguria në trafikun rrugorë dhe Parandalimi i ngacmimeve seksuale ku në këto ligjërata janë përfshi një numër i konsiderueshëm i nxënësve në nëntë shkolla .

**Kryetari** – Në bazë të raportit të zv.Komandantit të Policisë gjendja e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve është e kënaqshme dhe nëse keni ndonjë pyetje ju mund ta bëni për zv.Komandantin.

**Zahir Doda** – Në raport u përmend edhe raste të shpërndarjes së narkotikëve dhe nëse ka mundësi të jepni detaje rreth kësaj dukurie .

**Jaser Jaha** – Lidhur me këtë dukuri është një ekip i specializuar nga regjioni që i trajton rastet e rënda ndërsa për rastet e cekura në raport janë tri raste me sasi të vogël të cilën dukuri e kemi trajtuar në stacionin e Policisë .

**Fatmir Qaka** – Kjo temë që ka të bëjë me dukurin e substancave narkotike në bazë të planit të punës është i paraparë të diskutohet në mbledhjen e radhës dhe është mirë që të e kemi një raport më të detajuar .

### **3.Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje**

**Kryetari** – Është një dukuri shqetësuese në mbarë Kosovën dhe mendoj që në takimin e radhës të ftohen edhe zyrtarë nga Enti Social që me siguri se ata mundë të na njoftojnë në detaje rreth kësaj dukurie .

**Jaser Jaha** – Këtë dukuri e kemi trajtuar më specifikisht edhe pse kemi munges të stafit por që në trajtimin e këtyre rasteve kemi pasur ndihmën edhe nga regjioni .

Ka raste që hezitojnë të i lajmrojnë por thënë në përgjithësi ka vetëdijësim të shoqërisë për raportim të këtyre rasteve .

### **4.Aktivitete vetëdijësuese për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike**

**Kryetari** – Jemi në sezonin që duhet të mendojmë rreth masave dhe aktiviteteve që duhet të ndërmerren rrethë vetëdijësimin për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike edhe pse në Komunën tonë nuk kemi pasur raste të rënda në të kaluarën .

**Jaser Jaha** – Në bazë të raporteve që kemi marrë në të kaluarën fatmirësisht nuk kemi pasur raste të rënda të lëndimeve edhe pse përdorimi i këtyre mjeteve ka qenë i madhë .

Për muajin dhjetorë ne kemi një planë operativ rreth kësaj qështje dhe do të mundohemi që me aktivitete vetëdijësuese të e zvogëlojm mundësin e lëndimeve që kryesisht vijn nga gjeneratat e reja .

**Zahir Doda** – Aktivitete vetëdijësuese rreth kësaj qështje kemi pasur edhe në të kaluarën nëpër shkollat në bashkpunim me KFOR , FSK dhe Policinë e Kosovës dhe besoj që prap do të kemi ku prioritet do i japim ligjëratave rreth mjeteve piroteknike .

**Gzim Morina** – Ne si FSK jemi të gatshëm të bashkëpunojm edhe në ligjëratat për ofrimin e ndihmës së parë përmes ushtrimeve bazike por që gatishmëria jonë është edhe për aktivitete tjera vetëdijësuese .

### **5.Formimi i grupit punues për hartimin e planit të punës të KKSB-së për vitin 2025.**

**Kryetari** – Që nga fillimi i mandatit të KKSB-së në grupin punues për hartimin e planit të punës së KKSB-së kanë qenë Prof.Zahir Doda , Elmihane Malsiu dhe Fadil Guri dhe propozoj që ky grup të vazhdoj prapë në hartimin e këtij plani .

Me këtë propozim të Kryetarit u pajtuam të gjithë anëtarët dhe u pajtuam që ky grup punues të e përgatitë planin dhe në mbledhjen e fundit të këtij viti të e miratojm e më pastaj të e përcjellim për në Kuvend Komunal .

## 6. Të ndryshme

**Naim Hysa** – Desha të ju falenderoj juve si Komunë lidhur me një shqetësim që e ngrita në mbledhjen e kaluar për rrugën që të shpie në Shkollën fillore Emin Duraku në Dushkajë ku është intervenuar në rrugë dhe është sanuar problemi .

**Kryetari** – Është përgjegjësi e jona që me këtë kapacitet që e kemi të ofrojmë shërbime për qytetarët edhe pse ky vit ka qenë sfidues për shkak të mos përkrahjes nga niveli qendrorë .

**Fidaim Fazliu** – Deshta të paraqes një shqetësim rreth qasjes së personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve në objektin e Xhamisë .

Hyrja kryesore për në objektin e Xhamisë nuk ka qasje të përshtatshme dhe kërkesa ime është që a mund të krijohet një mundësi për rregullim të një trotuari dhe një pjerrine ngase në këtë pjesë ka lëvizje të automjeteve .

Ky institucion fetar ka edhe rëndësinë historike dhe vizitohet edhe nga vizitorë të ndryshëm , dhe është mirë të bëhet një zgjidhje për qasje duke e ngushtuar pjesën në anën e kundërt të trotuarit dhe të krijohet një hapësirë para hyrjes për qasje .

**Kryetari** – Edhe pse jam skeptik rreth zgjidhjes së kësaj çështje për shkak të hapësirës së pamjaftueshme ne edhe mundë të bisedojm me zyrtar Komunal dhe Policinë nëse mundë të ofrohet një zgjidhje .

Sa i përket qasjes së personave me aftësi të kufizuara mendoj se pjesa e epërme është e përshtatshme për qasje .

**Elmihane Malsiu** – Shoqata HANDIKOS gjithmonë ka ngritë zërin para institucioneve për qasje.

Komuna edhe pse ka punuar në këtë drejtim prap se prap ka defekte sa i përket qasjes .

Para një jave ishim në vizit objektit të Xhamisë dhe nga zyret tona e deri në objektin e Xhamis ka shumë vende që qasja nuk është e duhur .

Para dyerve të Xhamisë qasja nuk është e duhur, jo vetëm për personat me aftësi të kufizuara por edhe për të tjerët .

Sa i përket hapësirës mbrenda objektit të Xhamisë mendoj se nuk është e kushtueshme rregullimi i qasjes .

**Kryetari** – Të adresohen vendet ku janë të menagjuara nga Komuna e që mungon qasja dhe ne do e shohim mundësinë për intervenim .

**Jashar Selimi** – Mendoj se është hapësirë e pamjaftueshme të intervenohet në këtë pjesë për rregullim të një trotuari dhe një pjerrine ngase për ta bërë këtë duhet të mbyllet kjo rrugë .

## REKOMANDIMET

1. Të identifikohen vendet ku potencialisht përdoren nga abuzuesit e mjeteve narkotike .
2. Të përgatitet një raport më i detajuar për qështjen e narkomanizmit .
3. Të kërkohet një raport i detajuar nga Enti Social rreth dukurisë së dhunës në familje .
4. Të mirren masa paraprake rreth përdorimit të mjeteve piroteknike .
5. Të evindentohen vendet ku mungon qasja për personat me aftësi të kufizuara .

Kryesoi: Kryetari – ~~Z. Besmir Bashi~~



Procesëmbajtës: Fatmir Qaka

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Fatmir Qaka", written over a horizontal line.